

LEJIMI I TË PYETURIT “KU ËSHTË ALLAHU?” DHE PËRGËNJESHTRIM I ATYRE QË MOHOJNË LEJIMIN E KËSAJ

Dëshmi nga Suneti lidhur me lejimin e të pyeturit “Ku është Allahu?”

Nga dëshmitë e pasuesve të Sunetit dhe Xhematit në pohimin e epërsisë [uluww] të Allahut me qenien e Tij mbi krijesat e Tij është pyetja e qartë: ku është Allahu? Është transmetuar nga Imam Muslim në *Sahih* e tij nga Muawijeh bin el-Hakem es-Sulemij [radi Allahu anhu] i cili ka thënë:

“Kisha një robëreshë e cila m’i ruante delet mes Uhudit dhe Xhuwaanijeh. Një ditë prej ditësh, dola të shihja delet e mia dhe pashë që ujku kishte ngrënë njëren prej tyre. Meqë unë s’jam veçse një bir i Ademit [u hidhërova], i mëshova asaj. Pastaj shkova te i Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] [i tregova për këtë] dhe ai më mori në përgjegjësi për këtë. Unë i thashë:

- O i Dërguar i Allahut, a s’do ta lirosh atë?
- Sille te unë, - tha ai.

Kështu, unë e solla atë dhe ai [salallahu alejhi ue selam] e pyeti atë:

- Ku është Allahu?
- Mbi qiejt [fis-semaa], - u përgjigj ajo.
- Kush jam unë?
- Ti je i Dërguari i Allahut.
- Liroje, sepse vërtet është besimtare.⁹⁸

Kjo qartë tregon lejimin për të pyetur “Ku?” në lidhje me Allahun dhe për përgjigjen se Ai është mbi qiejt si dhe të faktin që të dëshmosh këtë është iman/besim në Allahun, për shkak të vërtetimit të epërsisë së Allahut mbi krijesat e Tij dhe se Ai është mbi qiejt. Selefi janë pajtuar rreth saktësisë së të pyeturit rreth Allahut dhe se përgjigja që duhet dhënë është se Ai është mbi qiejt. Gjithashtu, selefi kanë refuzuar këdo që ndalonte parashtrimin e kësaj pyetjeje dhe, në fakt, selefi e konsideronin ndalimin e parashtrimin të kësaj pyetjeje të jetë refuzim i veprimin të të Dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam] dhe refuzim i epërsisë [uluww] së Allahut. Hadithi i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] mjafton dhe i gjithë lavdi i takon Allahut. Në këtë ka dëshmi kundër atyre që përpiqen ta anulojnë parashtrimin e kësaj pyetjeje. Mirëpo, shumica prej tyre nuk kuptojnë.

TEKSTI I SELEFIT I CILI TREGON SE ËSHTË E LEJUESHME TË PYETET: KU ËSHTË ALLAHU?

⁹⁸ Transmetuar nga Muslim, 537.

Sulejman bin Terkhaan et-Tejmij ebul-Mu'temer el-Basrij [v.143H/760]

Sedekeh ka thënë:

“Kam dëgjuar et-Tejmij të thotë: ‘Nëse pyetem: ‘Ku është Allahu?’, do të them: në [dmth mbi] qiejt. Nëse pyetem: ‘Ku ishte Arshi i Tij para se Ai t’i krijonte qiejt?’, do të përgjigjem: Mbi ujë. Nëse pyetem: ‘Ku ishte Arshi i Tij para se Ai të krijonte ujin?’, do të them: Nuk e di”⁹⁹.

Imam *el-Alameh el-Hafidh en-Nakid Uthman bin Se'id ed-Darimij* [v.280H/893 e.s.]

Ai ka thënë në përgënjeshttrimin e atyre që ndalojnë parashtrimin e pyetjes: Ku është Allahu?:

“Gjithashtu, kam ekspozuar medhhebin e ndyrë të Xhehmive. Them: Nëse na thuhet: ‘Ku është Allahu?’, atëherë nuk themi se ai është i mishëruar në gjithçka. Nëse na thuhet: ‘Ku është Allahu?’, duhet të thuhet: Mbi Arsh dhe mbi qiejt ... Sa i përket çështjes se “ku?” nuk është e zbatueshme në rastin e Allahut, atëherë kjo është baza e qëndrimit të Xhehmit”¹⁰⁰.

Pra, reflekto mbi atë çka ka thënë lidhur me atë se ndalimi i të pyeturit “ku?” është baza e Xhehmive.

El-Kadij ebu Ja'la Muhamed bin el-Husejn el-Feraa [v.458H/1066 e.s.]

Ai ka thënë mbas tregimit të hadithit të robëreshës:

“Duhet ta dini se ka dy aspekte të kësaj thënieje:

1. se është e lejueshme të pyetet ku është Ai dhe të tregosh për këtë duke thënë se Ai është mbi qiejt;
2. thënia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]: ‘Liroje, se vërtet është besimtare’.

⁹⁹ Transmetuar nga el-Lalika'i, vëll.3, f.401 dhe transmetuar nga edh-Dhehebij në el-Uluww, f.130.

¹⁰⁰ *Er-Redd ala'l-Marisij*, vëll.1, f.489.

Sa i përket aspektit të parë, duket qartë se është e lejueshme të pyetet rreth Tij [duke pyetur “Ku?”], dhe është e lejueshme të tregosh se Ai është mbi qiejt. Sepse pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] i tha asaj: “Ku është Allahu?”. Pra, sikur të mos ishte e lejueshme, ai s’do ta pyeste. Ajo u përgjigj duke thënë se Allahu është mbi qiejt dhe pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] e pranoi këtë përgjigje. Kështu, sikur të mos ishte e lejueshme të tregohet rreth Allahut në këtë mënyrë, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] nuk do ta pranonte këtë pyetje”.

Deri aty ku thotë:

“Ahmed e ka shqyrtuar këtë në atë që transmetoi në *er-Redd ale’l-Xhehmijeh*”¹⁰¹.

Imam el-Hafidh Shemsudin Muhamed bin Ahmed bin Uthman edh-Dhehebi [v.748H/1347 e.s.]

Ai ka thënë mbasi përmendet hadithi i robëreshës:

“Në këtë, mund të shohim se krejt ata që pyeten ‘Ku është Allahu?’, bazuar në animin natyror [*fitra*], do të përgjigjen: ‘Në [mbi] qiejt’. Ka dy çështje në këtë transmetim:

1. Në shariat është e lejueshme për muslimanin të pyesë: Ku është Allahu?
2. Përgjigja në këtë: Në [mbi] qiejt.

Kështu, kushdo që refuzon këto dy çështje, ka refuzuar atë çka el-Mustafa [salallahu alejhi ue selam] ka bërë”¹⁰².

PRANIMI I KËTIJ PARIMI NGA EBUL-HASEN EL-ESH’ARIJ

Ai ka thënë në *el-Ibaneh*, në kaptinën mbi *Istiua ale’l-Arsh*:

“Një tjetër dëshmi është se dijetarët [rahimehumullah] kanë transmetuar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] se ka thënë: “Dy këmbët e robit [të Allahut] nuk do të mbesin pa lëvizur përpara Allahut të madhërisëm, derisa të pyetet për punët e tij”.

¹⁰¹ El-Kadu ebu Ja’la el-Firaa, *Ibtaal ut-Te’uilat* [Kuvajt: *Mektebet Dar edh-Dhehebi*, 1410H, botimi i parë, botues Muhamed el-Hamud en-Nexhdij], vëll.1, f.232.

¹⁰² *El-Uluww*, f.28.

Dijetarët transmetojnë që një njeri kishte ardhur te pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] më një robëreshë zezake dhe kishte thënë: "O i Dërguar i Allahut, dua ta lirojë si shpagim, kështu që a më lejohet ta bëjë këtë? I Dërguari tha:

- Ku është Allahu?
- Mbi qiejt [*fīs-semaa*], - u përgjigj ajo.
- Kush jam unë?
- Ti je i Dërguari i Allahut.
- Liroje, sepse vërtet është besimtare".

Kjo dëshmon se Allahu është mbi Fronin, mbi qiejt¹⁰³.

PRANIMI I KËTIJ PARIMI NGA ABDULLAH BIN SE'ID BIN KULLAB EL-KETTAN

Ai ka thënë në librin *es-Sifaat*, në kaptinën mbi *Istiua*, në atë çka transmetuam nga ibn Feurek:

"I Dërguari i Allahut, si krijesa më e dëlirë e më e mirë e Allahut, dhe krijesa më e ditur, e konsideroi të lejueshme të pyeste "Ku?". Dhe përgjigja e saktë është se Allahu është në [dmth mbi] qiejt dhe kjo dëshmon për iman. Xhehm ibn Sefuan dhe ithtarët e tij nuk e lejuan të pyetej "Ku?". Po të ishte kjo gabim, i Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] do të ishte i pari që do ta refuzonte dhe do të ishte e detyrueshme që t'i thoshte robëreshës: 'Mos fol kështu, sepse po thua se Allahu është i kufizuar dhe në një vend, por thuaj: Ai është gjithkund, jo në një vend. Kjo është e sakta e jo ajo çka the [se Ai është mbi qiejt]'¹⁰⁴.

Madje, i Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] e lejoi këtë [përgjigje], për shkak të dijenisë së tij rreth përmbajtjes së tij e të qenët e saktë dhe se kjo e bën të detyrueshme imanin për atë që e thotë [dmth që thotë se Allahu është mbi qiejt]. Nga ky shkak, i Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] dëshmoi se ajo kishte iman, kur e shprehu këtë. Pra, si mund të jetë e vërteta në kundërshtim me këtë, kur Libri e shpreh dhe dëshmon për këtë?

Nëse kjo që përmendëm nuk mjafton për të verifikuar saktësinë e medhhebit të Xhehmit lidhur me këtë, atëherë çka në lidhje me atë që është e rrënjësuar në animin natyror dhe në të kuptuarit e njerëzve? Se, nëse pyet cilindo, qoftë arab, qoftë joarab, besimtar apo mosbesimtar: Ku është Zoti yt?, ata s' do të përgjigjen ndryshe veçse: 'Në qiej', nëse do të

¹⁰³ El-Esha'rij, *el-Ibaneh*, f.103.

¹⁰⁴ Shënim: Pra, madje edhe Ibn Kullab, më në fund, i kuptoi pohimet qesharake të Xhehmit dhe të ithtarëve të tij, të cilat, fatkeqësisht, janë ringjallur nga vëllazëria Keutherite e Esharive bashkëkohore.

ketë mundësi ta artikulojë këtë; nëse jo, do të tregojë jo drejt tokës, bregdetit apo kodrës, por do të tregojë në drejtim të qiellit. Nuk gjejmë dikë tjetër veç Xhehmive të cilët pyeten për Zotin e tyre dhe thonë se Ai është gjithkund, duke pohuar se janë njerëzit më të mirë. Pra, intelektu u mjegullua, transmetimet u lanë dhe vetëm Xhehmi dhe pesëdhjetë burra të tjerë qenë udhëzuar! Kërkojmë shpëtim te Allahu nga çrregullimet.

Pastaj, Ibn Feurek tha:

“Ai – rahimehullah – pohoi në këtë kaptinë diçka nga medhhebi i tij:

Së pari, se është e lejueshme të pyetet: Ku është Allahu? Së dyti, saktësia e përgjigjes në këtë me ‘në [mbi] qiej’ dhe, së treti, kjo i referohet një konsensusi në veçanti dhe në përgjithësi”¹⁰⁵.

¹⁰⁵ Kjo qe transmetuar prej tij nga Shejhul-Islam ibn Tejmije në *Dera et-Te'arud*, vëll.6, f.193; *Nekd ut-Te'siis*, f.51-53 dhe *Mexhmu el-Fetaua*, vëll.5, f.319; Ibn el-Kajjim, *es-Seua'ik el-Murseleh*, vëll.4, f.1238; *Ixhtima'e Xhujush il-Islamijeh*, f.282.